

**SHOQERIA TREGTARE  
“Seleo 2024” SHPK**

**KONTRATE**

**P E R**

**THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE “Seleo 2024” SHPK**

**DURRES 12 Janar 2024**

## H Y R J E

Ne mbeshtetje te dispozitave kushtetuese neni 40 e vijues, ne referim te ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGETARE", te dispozitave perkatese per fitimin e personalitetit juridik parashikuar ne nenin 26 e vijues te K.C. me cilesine e ortakut te vetem themelues person juridik "**MANUFACTURE ITALIANA**" Sh.p.k., e pajisur me NUIS K11919502U, me seli në Durrës (Shqipëri), Xhafzotaj, Autostrada Durrës - Tiranë, Km 5, Ura e Fllakës, Zona Kadastrale 3852, Nr. Pasurie 298/45, 298/46, kapanon 1 kat, 150 m Rr. Nacionale Rr."Sali H.Imeraj" Fllake-Durres.

"**Manufacture Italiana**".Shpk perfaqeshet nga ortaku dhe administratori i vetem **Cipro Carmine**, shtetas italian, banues ne Shqiperi, mbajtes i pasaportes me Nr. AA 1345255.

Ne vijim dhe per efekt te pozites ne kete marredhenie kontraktuale "Manufacture Italiana" shpk do te cilesohet "Ortaku Themelues" i shoqerise "Seleo 2024" shpk.

### K O N T R A T E PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE "Seleo 2024" SHPK

#### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

##### N E N I 1

Ortaku themelues, ne mbeshtetje te ligjit 9901/2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregetare", si dhe ne pajtueshmeri me legjislacionin e Shtetit Shqiptar harton kete Akt-Themelimi te shoqerise "Seleo 2024" shpk.

##### N E N I 2

##### **Forma ligjore dhe kohezgjatja**

Shoqeria do te ushtroje te gjithe veprimtarine e saj ekonomike ne formen e nje "Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar" sipas legjislacionit te shtetit shqiptar dhe me emrtimin "Seleo 2024" shpk ne kuader te personit juridik dhe per gjigjet brenda kapitaleve te saj. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj tregetar per nje periudhe kohore mbi 10 vjecare nga momenti i rregjistrimit te saj ne QKB

##### N E N I 3


##### **Selia e Shoqerise dhe identifikimi**

Selia e shoqerise eshte Xhafzotaj, Autostrada Durrës - Tiranë, Km 5, Ura e Fllakës-Xhaf-Zotaj. Shoqeria mundet te krijoje NIP sekondar sipas nevojave te saj ne menyre te perkohshme apo dhe te perhershme.

##### N E N I 4

##### **Objekti i veprimtarise**

- Aktivite ekonomike te natyres Faxon, aktivitet tregtar import-eksport per artikuj kryesish te mallrave te konsumit ushqimor dhe ato industrilale.
- Shoqeria mund te kryeje veprimitari dhe ne fushen e pasurive te patundeshme, si dhe cdo lloj veprimitarie tjeter qe siguron fitime te ligjshme ne fushen imobiliare e te restaurimit, ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte ne keto pasuri imobiliare.
- Aktivitet nepermjet angjensive turistike, brenda dhe jashte territorit te Shqiperise, hapjen e qendrave te informacionit per investitorët e huaj si dhe per llogari te afariszteve shqiptare per njohjen e tregjeve jashte territorit te Shqiperise.



## N E N I 5 KAPITALI I SHOQUERISE

Shoqeria "Manufacture Italiana" shpk, krijon shoqerine "Seleo 2024" shpk si Ortak i Vetem i shoquerise me kontribut ne natyre per vleren prej 135.000.000 leke,

Pronat e vendosura si kontribut ne natyre perbehen nga

Pasuria 163/88, Zona kadastrale 2574, lloji i pasurise ARE me siperfaqe 4.010 m<sup>2</sup> dhe me vlore ne evidencen kontabel te shoquerise "Manufacture Italiana" shpk per 22.725.600 leke dhe

Pasuria 163/89, Zona kadastrale 2574, lloji i pasurise Truall me siperfaqe totale 4.990 m<sup>2</sup>, nga e cila Truall 4.990 m<sup>2</sup> dhe Ndertese 4.771 m<sup>2</sup> me vlore ne evidencen kontabel te shoquerise "Manufacture Italiana" shpk per 112.274.400 leke .

I gjithe kapitali themelor eshte i pandare dhe perbehet vetem ne nje kuote, teresisht te disponueshme nga ortaku themelues "Manufacture Italiana" shpk dhe ne kuptim te vleres ajo perfaqeson 100% te vleres se kapitalit themelor si kontribut ne natyre.

Shoqeria do te kete numer llogarie ne Banken e Shtetit Tirane dhe ne cdo banke tjeter jashte teritorit te shtetit shpiptar, por gjithmone e deklaruar ne bilancet e shoquerise.

## N E N I 6 Specifikime

Shoqeria private "Seleo 2024" shpk mund te ushtroje veprimtarine e saj te percaktuar ne nenin 4 te kesaj kontrate brenda dhe jashte teritorit te shtetit shpiptar nepermjet zyrave te perfaqesimit dhe filialeve te kontrolluara prej saj.

Shoqeria private "Seleo 2024" shpk i ka te gjitha autorizimet per te marre detyrimet e nevojshme ne kuader te veprimtarise ekonomike me persona te trete private ose shteterore, vendas dhe te huaj, si dhe per gjigjet ne baze te pasurise se vene, qe formon kapitalin shoqeror te themelimit.

## N E N I 7 Te drejta te ortakut themelues

Ortaku i vetem "Manufacture Italiana" Shpk gezon te drejten e pronesise ne kuoten e vetme te disponuar prej saj sipas investimeve te bera dhe ne rast shitje apo kalim te te drejtave te pronesise mbi kete kuote, eshte plotesisht e likuidueshme sipas legjisacionit te shtetit shpiptar dhe sipas precizimeve ne lidhje me kete procedure, te cilat percaktohen ne statut.

Krahas kapitalit fillestar ortaku i vetem ka te drejte te vere si pjesa kapitali themelor dhe pasuri te tjera te ligjeshme. luajteshme apo te pa luajteshme.

## N E N I 8 Fillimi i aktivitetit dhe zgjerimi

Shoqeria private "Seleo 2024" shpk do te filloje aktivitetin vetem pasi te behet regjistrimi i saj ne QKB dhe pas marrjes se licencimeve perkatese me miratimin e organeve kompetente te shtetit Shqiptar. Zgjerimi i aktivitetit te shoquerise ose prishja e saj do te behet ne perputhje me ligjin "Per shoquerite tregtare" dhe persa parashikohet ne statutin e shoquerise, i cili hartohet ne vijim e ne pajtueshmeri me kete kontrate themeluese.

## N E N I 9 Strukturat drejtuese dhe vendim marrja

Shoqeria "Seleo 2024" shpk gezon te drejten e administrimit dhe te ushtrimit te veprimtarise se saj ne perputhje me kete kontrate themelimi te statutit te saj dhe ne pajtueshmeri me legjisacion shqiptar.



Ortaku "Manufacture Italiana" shpk drejton veprimtarine e shoqerise "Seleo 2024" shpk duke u mbeshtetur ne te drejten e saj te pronesise private ne mjetet e investuara ne shoqueri, ne te drejten e saj si shoqueri kontrolluese dhe nepermjet organeve drejtuese qe jane:

- Asambleja e ortakeve themelues;
- Administratori i shoqerise Cipro Carmine me nje mandat prej 5 vitesh;
- Administrata e shoqerise, qe eshte ne vartesi te administratorit .

## N E N I 10

### **Asambleja e ortakeve dhe veprimaria e saj**

Asambleja eshte organi me i larte i shoqerise dhe te gjitha vendimet e saj si rregull Jane te karakterit kolegjal. Persa kohe qe shoqeria eshte me nje ortak te vetem, atributet e asamblese se ortakeve i gezon ortaku i vetem, dhe ne vijim do te cilesohet asambleja e ortakeve.

Administratori i shoqerise perfaqeson shoqerine brenda autorizimeve te dhena nga Asambleja se Shoqerise dhe parashikimet statutore, ndersa kompetencat e administrates rregullohen nepermjet nje akti te brendeshem te miratuar nga asambleja e shoqerise dhe ne vijim ne kontratat individuale te punes.

Asambleja e ortakeve zhvillon veprimtarine e saj nepermjet mbledhjeve per problemet e zakonshme dhe sipas rastit mund te provokoje dhe mbledhjet e jashtezakoneshme. Ajo vendos me nderhyrjen me vote favorizuese me te pakten 51% te kapitalit.

Mbledhjet e Asamblese te karakterit te jashtezakoneshem Jane ato mbledhje qe thirren me procedure te perspektuar dhe per rrethana te paparashikuara, dhe qe kryesisht lidhen me vazhdimin ose jo te veprimtarise ekonomike, marje kreditimesh apo dhe shlyerje te detyrimeve financiare, ndryshimi i formes juridike te shoqerise dhe per ato raste kur ligja per shoqerite tregetare kerkon prezencen e ortakeve qe disponojne me shume se 75% te kuotave.

Asambleja mblidhet jo me pak se nje here ne vit dhe te pakten nje here ne kater muaj ben bilancin e gjendjes ekonomike te shoqerise, sikurse parashikohet dhe ne statutin e saj.

## N E N I 11

### **Administratori**

Administratori i shoqerise ka te drejte te merret me te gjitha veprimtarite e shoqerise, te marre ne pune persona te ndryshem me kontrate te rregullt, te cilet i nevojiten shoqerise; te lidhe akt-marreveshje me persona te trete fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj. Per lidhje marreveshje ortakerie me firma, persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj, duhet marre pelqimi i Asamblese se Ortakeve. Pranohet nga ortaket qe administratori i shoqerise ka si organ ekzekutiv te tijin administraten e shoqerise.

## N E N I 12

### **Ndarja e fitimit**

Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve dhe shpenzimeve te tjera nga fitimi i shoqerise dhe ndarja e mjeteve per pagat e punetoreve shoqerise i mbetet ne dispozicion fitimi neto, i cili i ndahet ortakut apo ortakeve nepermjet administratorit te shoqerise, sipas rregullave te parashikuara ligjore.

Shoqeria e krijon fitimin e saj me ushtrimin e veprimtarise se saje te percaktuar ne kete kontrate dhe ne statutin e saj. Fitimi percaktohet nga miratimi i bilancit per cdo vit kalendarik dhe nese i shperndahet ortakeve ne forme devidenti, detyrimet ndaj shtetit duhet te jene te likujduara.

## N E N I 13

### **Marredheniet e punesimit dhe zgjidhja e mosmareveshjeve**

Marredheniet e punesimit ne shoqeri rregullohen nepermjet kontratave individuale te punes. Per ato probleme qe nuk rregullohen me kontrate pune do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Marredheniet e punes se administratorit te shoqerise, pavarsisht nga qenia apo jo ortak ne shoqeri, rregullohen me vendim te Asamblese se Ortakeve, ndersa kontrata formale nenshkruhet nga ortaku ose ortaket ne maxhorance.

Mosmarreveshjet midis punonjesve dhe shoqerise zgjidhen nga gjykata shqiptare, ndersa palet kontratuase meqe jane persona fizik te huaj, mosmarreveshjet mund t'i zgjidhin dhe ne nje gjykate tjeter. Ne rast se nuk arrjne nje marreveshje te shkruar per kete moment, organ kopetent gjyqesor eshte gjykata shqiptare.

Punonjesit nuk marrin pjesen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, pervec rasteve kur eshte percaktuar ndryshe ne kontrate. Per punen e tyre ne shoqeri punonjesit marrin pagen e tyre qe percaktohen ne kontraten individuale te punes.

#### N E N I 14

##### **Nenshkrimi i Akteve themeluese**

Kjo kontrate nenshkruhet nga perfaquesuesi i ortakut themelues, Cipro Carmine ne 4 kopje origjinale, dy ne gjuhen shqipe dhe ate italiane, qe disponohen nga ortaku themelues. Shumefishimi i ketij akti themelimi te shoqerise dhe ne pergjithesi te cdo dokumenti qe i perket shoqerise behet me dijeni dhe te administratorit te shoqerise dhe sipas kritereve qe percakton Asambleja e Ortakeve.

#### N E N I 15

##### **Efektet juridike te nenshkrimit**

Kjo kontrate themelimi hyn ne fuqi dhe quhet e e pranuar nga ortaku themelues "Manufacture Italiane" shpk se bashku me Statusin bashkelidhur ketij Akti me depozitim e saj ne Q.K.B. Tirane dhe me pajisjen me dokumentacion fiskal te nevojshem.

**Une Ortaku e "Seleo 2024" SHPK, autorizoj shtetasin Kostandin Heba, atësia Miltiadhi, amësia Parashqevi, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rruga Panjohur; Durrës; 0000; Durrës, lindur më 26/05/1959, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036247456 dhe nr. personal F90526121D, te kryej veprimet e regjistriimit te Statutit dhe Aktit te Themelimit te shoqerise se krijuar nga Ne, pranë Qendres Kombetare te Bkiznesit deri ne paisjen me Ekstrakt dhe NIPT-in perkates, te kerkajo dhe plotesoj çdo dokumentacion ligjore per kete qellim, te nenshkruaj kerkesa ne emrin tone, deri ne realizimin e regjistrimit dhe Çertifikimit te Shoqerise tone prane QKB, Tatim Taksave apo çdo institucion i ku kalon e drejta jone, duke zbatuar ligjin per Shoqerite Tregtare me ndryshimet e tij.**

U nenshkrua prej perfaquesuesit te ortakut themelues sot me date 12.01.2024, asistuar dhe ne prani te perkthyeses ligjore te njohur nga Ministria e Drejtësise Ana Dhamo.

#### ORTAKU I VETEM THEMELUES

**"Manufacture Italiana" shpk**

Perfaquesuar nga

**CIPRO CARMINE**

